

SHP Ohër dhe Debarcë

Është tejkaluar kontesti 17-vjeçarë, në mes SHP Ohër dhe Debarcë dhe Shoqatës së pensionistëve invalid

Për më pak se dy dekadëkontesti gjyqësorë rreth vërtetimit të pronësisë të Shtëpisë së pensionistëve



në mes SHP Ohër dhe Debarcë dhe Shoqatës së pensionistëve invalid të Ohrit dhe Debarcës, përfundimisht do të fitojë zgjidhje. Të dy shoqatat kanë nënshkruar Kontratë për bashkëpunim, ndihmës dhe mirëkuptimit, të cilin më 4 korrik 2019 kanë nënshkruar kryetari i SHP Ohër dhe Debarcë, Gjorgji Tërçeski dhe kryetari

i Pensionistëve invalid të Ohrit dhe Debarcës, Sllave Stojanovski.

Nënshkrimi i Kontratës paraprakisht ishte mbështetur pa rezervë nga Këshilli ekzekutiv i SHP Ohër dhe Debarcë dhe Kuvendi i pensionistëve invalid të Ohrit dhe Debarcës, ndërkaq me ndërmjetësim dhe mbështetje të plotë të LSHPM.

Në aktin e nënshkrimit të Kontratës për bashkëpunim, ndihmës dhe mirëkuptimit, ka marrë pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM m-r Ilija Adamoski, i cili me këtë rast ka thënë se është i kënaqur që marr pjesë në këtë akt dhe se LSHPM gjithnjë do të përkrah dhe do të jap mbështetje të plotë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tilla ndërmjet shoqatave, e sidomos nëse në mes të tyre ka konteste gjyqësore, të cilat nuk shkojnë në të mirë të asnjërës shoqatë.

Në nënshkrimin e Kontratës kanë marrë pjesë edhe kryetarët e SHP Solidarnost - Aerodrom, SHP Prilep dhe i SHP të invalidëve të punës nga Ohri.

K. Spaseski

Mbledhje e tretë e KE të LSHPM

Këshilli ekzekutiv i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, më 1.7.2019, ka mbajtur mbledhjen e tretë në të cilën përveç anëtarëve kanë marrë pjesë: kryetari i Kuvendit të LSHPM m-r Ilija Adamoski, nënkryetari i KE të LSHPM Mentor Qoku, sekretari i KE i Lidhjes Menka Trajkovska, kryetari i KM i LSHPM Mitre Stojanovski, kryetari i Komisionit për sport dhe rekreim Zdravko Petkovski dhe sektori i Re-

përgatitje të shkëlqyeshme, sidomos në paraqitjen e mirë të skenografisë së pasur e cila ishte bërë në mënyrë vullnetare pa harxhime mjeteve financiare. Pas diskutimit raporti është aprovuar, ndërkaq se cila shoqatë do të përfaqësoj Lidhjen dhe shtetin tonë në Lubjanë në festivalin e 19 ndërkombëtar të moshës së tretë, do të caktojë këshilli organizativ.

Raport për garat e mbajtura spor-



vyaleve regionale të këngëve muzikës dhe valleve Tomçe Stojkov.

Pikë më e rëndësishme e rendit të ditës ishte nënshkrimi i Propozim-memorandumit për bashkëpunim të LSHPM me Bashkësinë e vetëqeverisjes lokale - BLVL.

- Memorandum i këtillë është sjellë në vitin 2008, por meqë janë ndryshuar rrethanat dhe kushtet, ka nevojë të nënshkruhet i ri. Pikat në Memorandum janë në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale në shtet. Memorandumi do ta nxit dhe pasurojë bashkëpunimin në mes shoqatave dhe komunave, e nga ajo fitim më të madh do të kenë pensionistët, - ka thënë ndër të tjera në fjalën e saj kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova. Nënshkrimi i këtij Memorandumi të ri është aprovuar njëzëri nga të pranishmit.

Raport për revyalet e 8-ta regionale dhe republikane të këngëve muzikës dhe valleve në vitin 2019, ka dhënë seleksionuesi Tomçe Stojkov i cili ka potencuar se Revyali i këtij viti dallon me kualitet dhe

tive regionale ka dhënë kryetari i Komisionit për sport dhe rekreim pranë KE të LSHPM Zdravko Petkovski. Ai ka theksuar se garat sportive në vitin 2019, janë ndër më masivet deri më tani. Në ato kanë marrë pjesë 2 147 pensionistë sportist. Olimpiada sportive 2019, do të mbahet më 22 shtator 2019 në Radovish.

Në mbledhje është diskutuar edhe për mënyrën e dërgimit të mjeteve nga anëtarësia SHP Ohër dhe Debarcë përmes rrugës së recesionit. Është sjellë konkluzion që në të njëjtën mënyrë të vazhdohet edhe në 3 muajt e ardhshëm, por Shoqata sa më shpejtë të zgjidh këtë problem shumëvjeçar.

Më pastaj, është aprovuar propozimi që të dërgohet pyetësor tek të gjitha 53 shoqatat me qëllim që t'ju përgjigjen se çfarë formash të informimit do të donin në të ardhshmen, në çfarë tirazhi dhe me çfarë përmbytjes si dhe janë sjellë edhe disa vendime të tjera.

Kalina S. Andonova

Takim pune me ministren e punës dhe politikës sociale Mila Carovska

Prioritet për LSHPM është sjellja e Ligjit për organizimin pensionist

Ministria për punë dhe politikë sociale Mila Carovska, më 1 korrik 2019, ka realizuar takim pune në LSHPM, në të cilën kanë marrë pjesë anëtarët e Këshillit ekzekutiv të Lidhjes, kryetari i Kuvendit të LSHPM m-r Ilija Adamoski, kryetari i Forumit juridi-

ka folur edhe kryetarja Stanka Trajkova e cila ka potencuar:

- Organizata e pensionistëve në vendin tonë ka specifikat e veta për çka nuk përshatet ligji ekzistues për shoqata dhe fondacione. Ky Propozim - ligj ka qenë në diskutim publik në të



ko-ekonomik d-r Fidanço Stoev, kryetari i Komisionit të shtëpive për pleq, shtëpive pensioniste dhe standard të pensionistëve Mite Stefanov, dhe përfaqësues të tjerë të komisioneve dhe trupave të rëndësishëm. Me takimin e punës ka drejtuar kryetarja e LSHPM Stanka Trajkova. Në rend dite të takimit ishin tema të cilat ishin me prioritet për mbi 320.000 pensionistë të vendit dhe për gjeneratat e ardhshme të pensionistëve edhe atë: sjellja e Ligjit për organizimin pensionist; ndërtimi i shtëpive për pleq dhe për pensionistë dhe harmonizimi i pensioneve respektivisht për rritjen e pensioneve në periudhën e ardhshme.

Për nevojën e sjelljes së Ligjit për organizimin pensionist në Maqedoni, fjalë hyrëse ka dhënë kryetari i Forumit juridiko-ekonomik d-r Fidanço Stoev i cili ka arsyetuar nevojën për sjelljen e një ligji të tillë. Për rëndësinë dhe nevojën e sjelljes së një ligji të tillë

gjitha 53 shoqatat edhe atë dy herë brenda 6 viteve. Numri më i madh i shoqatave, 45 në numër, janë për sjelljen e një ligji të këtillë. Janë 8 shoqata të cilat janë skeptike, por argumentet e tyre nuk janë reale dhe nuk u përgjigjen situatave reale. Në përgatitjen e Propozim-ligjit janë vënë të gjitha vërejtjet e dhëna nga diskutimi publik. Ligji do të vë rend në të gjithë 4 lidhjet ekzistuese, e jo vetëm në LSHPM, respektivisht do të sjellë dobi për të gjithë 320.000 pensionistët. Ky ligj, në asnjë mënyrë nuk ndërhyjnë në pavarësinë e financimit dhe punës së shoqatave. Ato edhe në vazhdim janë subjekte juridike me statutet e veta, programe dhe punës së pavarur ashtu siç janë edhe tani.

Në takim ka folur ministria për punë dhe politikë sociale Mila Carovska e cila ka thënë se është shumë me rëndësi që të ketë takime të këtilla në të cilat do të ketë diskutime konstruktive

Garat e 24-ta regionale sportive të pensionistëve 2019

Për herë të parë në regionalet kanë marrë pjesë të gjitha shoqatat, ndërkaq, 47 do të marrin pjesë në "Olimpiadën 2019"

Garat e 24-ta Regionale sportive të pensionistëve këtë vit në të gjitha 8 regionet në Republikë, janë mbajtur në periudhën kohore prej 21 maj deri më 23 qershor në koordinim të tërësishtëm me Komisionin për sport pranë KE të LSHPM. Në garat regionale të këtij viti, kanë garuar garues në numër rekord prej 2 147 nga të cilët 1 346 në meshkuj dhe 801 garues në konkurrencën femra nga të gjitha 53 shoqatat anëtare të LSHPM. Është për tu theksuar se të gjitha shoqatat anëtare të LSHPM me garuesit e vet drejtpërdrejtë kanë marrë pjesë në garat regionale që nuk ishte rast deri më tani.

Pjesëmarrja e numrit të garuesve prej viti në vit shkon në rritje që përfa-

dhe realizuar aktivitete të cilat mundësojnë plakje aktive dhe të shëndetshme.

Edhe këtë vit, garuesit kanë garuar në të gjitha 11 disiplinat sportive në 23 kategori të parapara me Rregulloren për lojëra sportive. Edhe pse numri i garuesve është në rritje e sipër, vend për aktivitete në shoqata ka edhe shumë duke marrë parasysh të dhënen që në garat regionale mund të marrin pjesë maksimum 3 276 garues, ndërkaq, kanë marrë pjesë 2 147.

Meriton të theksohet se këtë vit në Garat republika-



që ju paraprindë garave regionale si dhe përmbytjes së tyre lirisht mund të thuhet se garat në të gjitha nivelet prej viti në vit fitojnë në kualitet dhe kuantitet sidomos atje ku atyre ju paraprindë përgatitje më të gjera gjithëpërfshirëse.

Posaçërisht është për tu theksuar edhe fakti se në numrin më të i madh në garat regionale ishin të pranishëm të parët e komunave ose përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, të cilët në fjalimet e tyre para të pranishmëve kanë thënë fjalë shumë pozitive për bashkëpunimin në mes vetëqeverisjes lokale dhe shoqatave të pensionistëve dhe se gjithnjë u japin mbështetje dhe mirëkuptim në zgjidhjen e problemeve të tyre.

Zdravko Petkovski
Kryetar i Komisionit për sport dhe rekreim pranë LSHPM



qëson shenjë të mirë për interesimin e pensionistëve për pjesëmarrje në aktivitete sportive të cilat i realizon LSHPM e cila me të vërtet kujdeset për anëtarësinë e vet duke siguruar

ne të drejt paraqitjeje me garuesit e tyre kanë siguruar numër rekord 47 shoqata gjë që nuk ishte rast deri më tani.

Duke analizuar të gjitha aktivitetet